



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

**KODI I ETIKËS SË UNIVERSITETIT
"FAN S. NOLI" KORÇË**

Miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. *628*, datë *23. 12. 2022*.....

Shëtitörja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@yahoo.com

PREAMBULA

1. Të vetëdijshëm për funksionin arsimor, kërkimor dhe social të një institucioni të arsimit të lartë, Universiteti "Fan S. Noli" (më poshtë Universiteti), njeh parimet themelore dhe vlerat etike të pranuar nga komuniteti shkencor ndërkombëtar në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe të gjitha veprimtaritë e tjera universitare.
2. Universiteti "Fan S. Noli" mbështet përgjegjësinë dhe angazhimin institucional dhe individual të komunitetit akademik. Ai e konsideron etikën dhe sjelljen e përgjegjshme si vlera themelore për ndjekjen e qëllimeve institucionale, për nxitjen e meritës dhe përsosmërisë, për shkëmbime me komunitetin shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar, në krijimin e një mjedisi profesional, që është i hapur ndaj dialogut, marrëdhënieve ndërpersonale dhe mbrojtjes së vlerave individuale.
3. Përmes këtij dokumenti, në vijim referuar si "Kodi", Universiteti "Fan S. Noli" i kërkon personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentëve, secili brenda rolit dhe funksionit institucional, të përmbushë dhe të promovojë:
 - a. parimet themelore të njohura nga Konventa dhe Karta e të Drejtave të Njeriut; parimet etike të Magna Charta Universitatum, të referuara në udhëzimet ndërkombëtare për Kodin Institucional të Etikës në Arsimin e Lartë; parimet e Kodit Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor dhe të Kartës Evropiane të të Drejtave të Studentëve.
 - b. ligjet kushtetuese dhe dispozitat normative në lidhje me transparencën dhe shpërndarjen e informacionit nga administrata publike; parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe paligjshmërisë; Rregullat e Etikës në Administratën Publike.
 - c. parimet themelore dhe udhëzimet e parashtruara në Pjesën I të Statutit të Universitetit.

PJESA I - PARIMET ETIKE TË UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Ky Kod është hartuar në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit Nr. 9131 datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të VKM nr. 329, datë 12.4.2017, “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, të Statutit si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, që përfshijnë fushën e veprimit të këtij kodi.

Neni 2 Qëllimi

Kodi i Etikës ka për qëllim të vendosë rregullat e sjelljes bazuar mbi parimet etike për të gjithë anëtarët e Univerisitetit “Fan S. Noli” Korçë, duke përfshirë personelin akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentët. Kodi synon të ruajë vlerat themelore të komunitetit universitar, të sigurojë njohjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive personale, si dhe të garantojë detyrat dhe përgjegjësitë etike dhe sociale ndaj institucionit. Ky Kod informon të gjitha palët e interesuara mbi politikat dhe procedurat e etikës dhe të rregullave të sjelljes në Universitetin “Fan S. Noli”, si edhe për rastet e papajtueshmërisë me këto rregulla.

Neni 3 Fusha e veprimit

Kodi i Etikës është i detyrueshëm për zbatim në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë, në të gjitha njësitë përbërëse të tij. I gjithë personeli, pavarësisht nga forma dhe lloji i kontratës së punës, personel akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e këtij Kodi. Gjithashtu, këto dispozita janë të detyrueshme edhe për studentët që ndjekin studimet në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë.

KREU II PARIMET KRYESORE

Neni 4 Parimi i Ligjshmërisë

1. Çdo anëtar i Universitetit "Fan S. Noli" Korçë duhet të sillet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Shqipërisë, Statutin, Rregulloren si dhe akte të tjera të brendshme të Universitetit.
2. Çdo sjellje joligjore dhe joetike është e ndaluar.
3. Çdo person, veprimet ose mos veprimet e të cilit çënojnë apo shkelin dispozitat e këtij Kodi, do të mbajë përgjegjësi në përputhje me rregullat dhe masat disiplinore të përcaktuara.

Neni 5 Parimi i Integritetit

1. Çdo anëtar i Universitetit "Fan S. Noli" duhet të sillet në mënyrë të sinqertë, duke respektuar parimet dhe vlerat etike, në mënyrë që të tjerët të kenë besim tek ai.
2. Parimi i integritetit zbatohet kur detyrat realizohen në përputhje me misionin e Universitetit "Fan S. Noli" dhe duke shfaqur profesionalizëm, përgjegjshmëri, kompetencë dhe ndershmëri në përmbushjen e tyre.
3. Çdo anëtar duhet të përmbushë detyrat e tij në kohën e duhur dhe të shmangë sjelljet të cilat mund të diskreditojnë apo dëmtojnë reputacionin e universitetit, personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentëve.

Neni 6 Parimi i Barazisë dhe Mos-Diskriminimit

1. Përbën **diskriminim të drejtpërdrejtë** kur, në bazë të cilitdo prej motiveve të përcaktuara dhe të sanksionuara në këtë kod dhe në legjislacionin në fuqi, një individ trajtohet në mënyrë më pak të favorshme nga sa është trajtuar apo do trajtohej një tjetër, në një situatë të ngjashme.
2. "**Diskriminim i tërthortë**" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në legjislacionin në fuqi, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi,

ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

3. Universiteti "Fan S. Noli" Korçë i trajton të gjithë individët mbi bazën e parimit të barazisë, drejtësisë dhe respektit.
4. Të gjithë anëtarët e Universitetit kanë të drejtë të trajtohen në mënyrë të barabartë, me mirëkuptim, respekt dhe nderim, duke mos ju nënshtuar në asnjë moment diskriminimit direkt apo indirekt, për shkak të një apo më shumë faktorëve duke përfshirë: fenë, gjininë, orientimin seksual, ndërgjegjjen apo bindjen personale, aspektin fizik dhe ngjyrën, gjuhën, origjinën etnike apo shoqërore, nënshtetësinë, kushtet personale dhe të shëndetit, shtatzëninë, zgjedhjet familjare, moshën, etj.
5. Universiteti "Fan S. Noli" Korçë promovon krijimin e një mjedisi produktiv dhe të respektueshëm pune dhe studimi dhe nuk pranon asnjë formë paragjykimi, ngacmimi apo shqetësimi të ardhur për shkak të cilitdo prej motiveve të sanksionuara në këtë Kod dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Parimi i Objektivitetit

1. Çdo anëtar i Universitetit "Fan S. Noli" Korçë duhet të përmbushë detyrat ditore me objektivitet dhe paanshmëri.
2. Çdo anëtar i Universitetit "Fan S. Noli" Korçë duhet të jetë i kujdesshmën që shprehja e pikëpamjeve apo qëndrimeve të tij, të mos rrezikojë në mënyrë subjektive rezultatet e detyrave të caktuara apo interesat e Universitetit.
3. Parimi i objektivitetit çënohet nga çdo veprim, mosveprim apo trajtim preferencial i kryer nga paragjykimi, favorizimi apo nga interesa personale, familjarë, socialë apo politikë.

Neni 8

Parimi i Konfliktit të Interesit

1. Një "**konflikt interesi**" është një rrethanë ku interesi personal i dikujt ndikon ose duket se do të ndikojnë në mënyrë të padrejtë gjykimin ose veprimet profesionale të tij, gjatë realizimit të detyrave kundrejt Universitetit.
2. Të gjithë anëtarët e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, duhet të respektojnë parimet e drejtësisë dhe paansisë, gjatë zbatimit të detyrave të tyre. Ata duhet të punojnë në interes të Universitetit dhe duhet të shmangin situatat e konfliktit të interesit.
3. Kemi të bëjmë me **nepotizëm apo favorizëm**, kur një pjesëtar i personelit akademik, ndihmës-akademik apo administrativ, direkt ose indirekt, përdor autoritetin e tij apo aftësinë bindëse për të dhënë përfitime, për të favorizuar detyra apo emërimet, për të ndikuar mbi përfundimet e konkurseve apo në procedurat e përzgjedhjes që kanë të

bëjnë, në veçanti, por jo ekskluzivisht, me fazën fillestare të formimit në karrierën universitare apo në dhënien përparësi të fëmijëve, familjarëve apo personave që bashkëjetojnë me ta.

4. Nepotizmi përfshin, gjithashtu, të gjitha format e favorizimeve ndaj studentëve dhe bashkëpunëtorëve në pozita vartëse, ku kjo kuptohet si sjellje e pajustificuar dhe arbitrare, që bie në kundërshtim me rregullat e mosdiskriminimit dhe njohjes së meritës dhe mund të dëmtojë prestigjin e Universitetit.
5. Universiteti "Fan S. Noli" Korçë dënon nepotizmin dhe favorizimin, të cilët bien në kundërshtim me dinjitetin njerëzor, vlerësimin e meritave individuale, profesionalizmin dhe lirinë akademike, ligjshmërinë, paanësinë dhe transparencën dhe u kërkon stafit akademik dhe çdo anëtar tjetër të përmbahet nga të tilla praktika dhe t'i referojnë Këshillit të Etikës rastet e sjelljeve të dyshimta.
6. Në përputhje me parimet e veta themelore, të lirisë akademike dhe autonomisë, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë është institucion i lirë dhe i pavarur nga të gjitha format dhe kushtëzimet e interesave të jashtme. Universiteti kërkon që anëtarët e saj, në kryerjen e detyrave të tyre institucionale, të respektojnë parimet e korrekhtësisë dhe paanësisë, duke punuar para së gjithash në interes të Institucionit, duke shmangur situatat e konfliktit të interesave.
7. Ka konflikt interesi, kur interesi vetjak i një anëtar të universitetit, me përjashtim të studentit, bie në kundërshtim realisht apo potencialisht me interesin, jo vetëm ekonomik, të universitetit.
8. Orientimi i studentëve për të blerë mallra ose shërbime tek një anëtar i stafit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ që i ofron ato, përbën konflikt interesi.
9. Kur emëron përfaqësuesit e tij në organe, kompani dhe organizata të tjera, Universiteti merr përsipër të shmangë të gjitha konfliktet e mundshme dhe të veprojë para së gjithash në interes të Institucionit.
10. Anëtar i Universitetit, që në një veprim apo rrethanë të caktuar ka interes në konflikt me ato të Universitetit, duhet të njoftojë menjëherë organin ose personin përgjegjës apo hierarkisht epror, si dhe duhet të kufizohet nga shqyrtime apo vendime të mundshme që kanë të bëjnë me të.

Neni 9

Parimi i kofidencialitetit

1. Në përpunimin e të dhënave personale, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë siguron respektimin e të drejtave, lirive themelore dhe dinjitetit të personave në fjalë. Ai kërkon që anëtarët e komunitetit universitar të përdorin të dhënat në lidhje me veprimtarinë e universitetit brenda roleve që ata kryejnë dhe në përputhje me sekretin profesional, duke

siguruar konfidencialitetin e çdo informacioni të marrë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2. Universiteti "Fan S. Noli" Korçë merr përsipër të sigurojë drejtpeshimin midis lirive themelore personale dhe nevojës për të matur dhe monitoruar veprimtaritë institucionale.

**PJESA II - RREGULLAT E SJELLJES GJATË VEPRIMTARIVE MËSIMORE,
KËRKIMORE DHE ADMINISTRATIVE**

**KREU III
TË DREJTAT DHE DETYRAT E PERSONELIT AKADEMIK**

**Neni 10
Transmetimi i njohurive dhe liria akademike**

1. Personeli akademik gëzon lirinë akademike në kërkim, punën shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies.
2. Personeli akademik duhet të sigurojë nivel të lartë performance në kërkim, mësimdhënie dhe praktikë nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentimit, vëzhgimit, duke përdorur metoda eficiente dhe të lehta në përdorim nga studentët.
3. Pedagogu i lëndës duhet t'ju bëjë të qartë studentëve objektivat e lëndës, si dhe t'ju shpjegojë metodën e vlerësimit të tyre.
4. Staf i akademik duhet të njohë dhe të respektojë kontributin shkencor të kolegëve dhe studentëve.
5. Staf i akademik duhet të punojë në përputhje me ligjet mbi të drejtën intelektuale dhe të mbrojtjes të autorit.

**Neni 11
Përgjegjësitë e personelit akademik**

Në përmbushje të detyrave të tij, personeli akademik duhet të pajtohet me standardet e mëposhtme etike e profesionale:

1. Çdo anëtar i personelit të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë duhet:
 - a. të promovojë interesat më të mira të Universitetit;
 - b. të punojë për realizimin e misionit, vizionit dhe vlerave të Universitetit;
 - c. të ruajë respektin dhe besimin e publikut ndaj Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, dhe integritetin e tij;
 - d. të shfaqë integritet personal, ndershmëri dhe përgjegjësi në të gjithë veprimet e tij;
 - e. të sigurojë një mjedis të respektit reciprok, të paanshmërisë dhe të bashkëpunimit;

- f. të ruajë konfidencialitetin e të gjitha çështjeve sipas parashikimeve të bëra në ligj;
- g. të sigurojë zgjidhje të pavarura të çështjeve;
- h. të sigurojë që marrëdhëniet të cilat janë ose mund të perceptohen si konflikte interesi, të jenë plotësisht të hapura dhe të ndiqen nga udhëzimet e organeve kolegjiale të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë;
- i. të ketë përputhshmëri me politikat dhe procedurat e Universitetit dhe ligjet në fuqi;
- j. të demonstrojë përkujdesje ndaj pronës dhe burimeve të Universitetit;
- k. të respektojë orarin e punës, sipas kontratës së punës;
- l. të paraqitet me veshje serioze në përshatje me funksionin që kryen. Veshja e personelit të universitetit duhet të përmbushë standardet e profesionalizmit dhe të modestisë, pa u bërë shkak debati dhe tërheqje vëmendjeje;
- m. të zbatojë me korrektësi detyrën dhe urdhrat e eprorit, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore;
- n. të shmangë rastet kur ka konflikt interesash sipas legjislacionit në fuqi, duke i deklaruar ato përpara eprorit sapo të jenë shfaqur;
- o. të mos lejojë që interesat personale të prekin marrëdhëniet profesionale;
- p. të mos bëjë dallime midis studentëve, vartësve apo kolegëve për shkak të njohjeve apo parapëlqimeve vetjake;
- q. të trajtojë në mënyrë të barabartë vartësit, kolegët dhe studentët, duke shmangur cënime të dinjitetit, të personalitetit dhe të mendimeve të tyre profesionale, pavarësisht mospërputhjes së mendimeve dhe/ose interesave;
- r. të mos konsumojë pije alkoolike apo duhan në mjediset e brendshme të institucionit;
- s. të mos përgojë, të mos shpifë e të mos njosë imazhin profesional e personal të anëtarëve të tjerë të personelit të Universitetit.

Neni 12

Përgjegjësitë gjatë procesit mësimor

1. Anëtarët e komunitetit universitar marrin përsipër të kryejnë veprimtaritë e tyre mësimore në përputhje me organizimin dhe planifikimin e përgjithshëm të strukturave përkatëse të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë.
2. Stafit akademik është i detyruar të përmbushë me përgjegjësi dhe korrektësi rolin e tij edukativ, duke mbështetur rritjen akademike dhe kulturore të studentëve nëpërmjet mekanizmave dhe veprimtarive shkencore të garantuara dhe të mbështetura edhe nga parimet e Kartës Evropiane të Drejtave të Studentëve.

3. Vlerësimi i studentëve bëhet sipas procedurave të miratuara në Rregulloren e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, për të cilat studentët njoftohen paraprakisht. Ky vlerësim kryhet në përputhje me nevojat e programeve lëndore të miratuara në programin e studimit. Këshillimi i studentëve për çështje të mësimdhënies dhe të nxënies në kohën dhe vendin e përcaktuar brenda mjediseve të Universitetit, është pjesë thelbësore e detyrave akademike të stafit mësimdhënës. Çdo veprimtari tjetër e ngjashme, e kryer kundrejt një shpërblimi material nga ana e palëve të interesuara, konsiderohet shkelje sipas përcaktimeve të këtij Kodi.
4. Stafi akademik i Universitetit "Fan S. Noli" Korçë duhet të përdorë gjuhën zyrtare dhe një fjalor të përshtatshëm, brenda normave të etikës së komunikimit dhe të sjelljes qytetare.
5. Stafi akademik i Universitetit "Fan S. Noli" Korçë duhet të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime nga studentë apo persona të tjerë, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve të larta apo favore e përfitime të tjera, të cilat anëtarit i personelit akademik mund t'i kryejë për shkak të detyrës. Identifikimi i rasteve të tilla ndëshkohet sipas procedurave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
6. Stafi akademik duhet të mos bëjë dhe të mos bëhet pre e provokimeve, ngacmimeve të të gjitha formave nga studentët apo personat e tjerë për shkak të punës, për qëllime që bien në kundërshtim me këtë Kod, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me normat morale.

Neni 13

Konsideratat etike në kërkimin shkencor

1. Universiteti inkurajon dhe promovon kërkim shkencor me cilësi të lartë.
2. Personeli akademik duhet të sigurojë që kërkimi shkencor të zhvillohet në përputhje dhe në pajtueshmëri të plotë me standardet etike. Kërkuesit shkencorë duhet të udhëhiqen nga ligji mbi të drejtën e autorit.
3. Kërkuesit shkencorë duhet të udhëhiqen nga parimet bazë të integritetit kur realizojnë kërkimin e tyre si:
 - a) Të sigurojnë kërkime cilësore;
 - b) Të zhvillojnë dhe komunikojnë rezultatet me transparencë, drejtësi dhe paanshmëri;
 - c) Të respektojnë dhe të njohin kontributin dhe punën e kolegëve;
 - d) Të kujdesen për trashëgiminë kulturore dhe mjedisin;
 - e) Të respektojnë dhe të sigurojnë përgjegjshmëri sociale gjatë kërkimit.

4. Personeli i cili zhvillon kërkim shkencor ka përgjegjësi të zbatojë parimet, normat dhe standardet e etikës në kërkim si dhe t'iu përgjigjet në mënyrën e duhur cënimit të integritetit ose shkeljes të të drejtës të autorit apo të pronësisë intelektuale.
5. Publikimet e gjithsecilit duhet të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat që lidhen me pronësinë intelektuale dhe plagjiaturën. Plagjiatura është përvetësimi dhe vjedhja e ideve apo punës së autorëve të tjerë dhe përfaqësimi i tyre si vepra origjinale, duke shkelur të drejtat e autorit dhe pronësinë intelektuale.
6. Universiteti "Fan S. Noli" Korçë dënon dhe ndalon plagjiaturën dhe shkeljen e ligjit mbi pronësinë intelektuale.
7. Shkelja e integritetit në kërkimin shkencor mund të përbëhet, por nuk mund të jetë e kufizuar vetëm në rastet e mëposhtme:
 - a) Manipulimi i autorësisë ose denigrimi i rolit të kërkuesve të tjerë në publikim;
 - b) Autoplagjiatura – publikimi i pjesëve më të rëndësishme të një publikimi të vjetër si të ri;
 - c) Fshehje të pjesshme ose të plotë të rezultateve të kërkimit;
 - d) Krijimi i paragjytimeve apo rezultateve mashtruese;
 - e) Keqpërdorimi apo abuzimi me pozicionin për të kryer shkelje në kërkimin shkencor;
 - f) Mashtrimi nëpërmjet citimeve dhe bibliografisë fiktive;
 - g) Fshehje të shkeljeve të mundshme të integritetit në kërkim të bëra nga persona apo institucione të tjera, të cilat ndikojnë mbi Universitetin apo anëtarët e tij.

Neni 14

Përgjegjësitë e personelit ndihmës-akademik dhe administrativ

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë ka për qëllim krijimin e një mjedisi pune të rehatshëm, si dhe të inkurajojë një komunikim efektiv midis të gjitha niveleve dhe pjesëve përbërëse të tij.

1. Personeli ndihmës-akademik dhe administrativ duhet të zbatojë me etikë, korrektësi dhe përpikmëri të gjitha detyrat që ju janë ngarkuar mbi bazën e statutit, rregulloreve të brendshme apo akteve të tjera ligjore.
2. Personeli ndihmës-akademik dhe administrativ duhet të respektojë kolegët, personelin akademik, studentët dhe të sillen në mënyrë korrekte ndaj tyre në përputhje me rregullat etike dhe morale, pa cënuar dinjitetin personal të asnjë individi.
3. Ata duhet të shfaqin sjellje profesionale gjatë punës pranë këtij institucioni.
4. Duhet të paraqiten me veshje serioze në përshtatje me funksionin që kryejnë. Veshja e personelit ndihmës-akademik dhe administrativ të universitetit duhet të përmbushë

standardet e profesionalizmit dhe të modestisë, pa u bërë shkak debati dhe tërheqje vëmendjeje.

5. Personeli ndihmës-akademik dhe administrativ duhet të respektojë orarin e punës (orën e mbërritjes në punë dhe orën e largimit prej saj), të zbatojnë detyrat e tij funksionale, si dhe detyrat e caktuara nga eprori i tyre apo titullari i institucionit (rektori/administratori).
6. Personeli ndihmës-akademik dhe administrativ duhet të raportojë tek eprori mashtrimin, keqpërdorimin e fondeve, vjedhjen apo keqpërdorimin e burimeve dhe asetëve të Universitetit, si dhe shkeljen e politikave dhe rregulloreve të tij.
7. Personeli ndihmës-akademik dhe administrativ duhet të shmangë rastet e favorizimit ndërmjet studentëve, nënpunësve dhe kolegëve, për shkak të preferencave apo interesave personale.
8. Personeli ndihmës-akademik dhe administrativ, gjatë orarit të punës nuk duhet të provokojë apo ngacmojë asnjë punonjës të Univeritetit ose student, në kundërshtim me këtë Kod apo legjislacionin në fuqi.
9. Personeli ndihmës-akademik dhe administrativ nuk duhet të konsumojë pije alkoolike gjatë orarit të punës si dhe nuk duhet të pijë duhan në ambientet e mbyllura të Universitetit.
10. Personeli ndihmës-akademik dhe administrativ nuk duhet të përdorë klasat apo ambientet e tjera të Universitetit për aktivitete që nuk kanë lidhje me mësimin ose trajnimin pa marrë miratimin e titullarit.
11. Personeli ndihmës-akademik dhe administrativ duhet të kujdeset për sigurinë dhe konfidencialitetin e anëtarëve të Universitetit.
12. Personeli ndihmës-akademik dhe administrativ nuk duhet të keqpërdorë logon dhe emrin e Universitetit.

KREU IV TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTËVE

Neni 15 Të drejtat e studentëve

Studentët e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë gëzojnë të drejtat dhe liritë e mëposhtme:

1. Çdo student ka të drejtën të jetë i lirë nga diskriminimi racor, fetar, etnik, përkatësia politike, mosha, gjinia dhe aftësitë e kufizuara.

2. Studentët kanë të drejtën e lirisë së shprehjes, të mbledhjes dhe grupimeve për aq kohë sa shfrytëzimi i këtyre lirive pajtohet me politikat e Universitetit, nuk ndërhyjnë në funksionimin normal të programeve të studimit dhe respekton të drejtat e të tjerëve.
3. Studentët janë të lirë të organizojnë dhe marrin pjesë në organizata studentore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të promovuar interesin e tyre të përbashkët brenda Universitetit. Organizatat studentore janë të lira të shqyrtojnë dhe diskutojnë të gjitha çështjet e interesit, në zbatim me rregulloren e Universitetit. Organizatat e njohura dhe të pranuar mund të gëzojnë privilegjin të përdorin godinat, lehtësirat dhe shërbimet e Universitetit, sipas politikave dhe procedurave administrative të tij.
4. Studentët kanë të drejtën të jenë të lirë nga çdo lloj ngacmimi, nga anëtarët e komunitetit të Universitetit. Studentët kanë të drejtën dhe përgjegjësinë të raportojnë, në mirëbesim dhe pa frikë hakmarrjeje, çdo shkelje të këtij Kodi apo politike të Universitetit tek Këshilli i Etikës, drejtuesit akademikë apo administrativë të tij.
5. Studentët kanë të drejtën të informohen mbi politikat dhe procedurat, të cilat lidhen me procesin disiplinor dhe masat disiplinore.

Neni 16 Detyrimet e studentëve

1. Studentët në ambientet e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, duhet:
 - a. të zbatojnë orarin e mësimit dhe t'u përmbahen rregullave të sanksionuara në Statutin dhe në Rregulloren e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë;
 - b. të paraqiten në mënyrë serioze në mjediset e institucionit, që përfshin një veshje të përshtatshme dhe dinjitoze pa u bërë shkak debati dhe tërheqje vëmendjeje, si dhe përdorimin e një fjalori në përputhje me normat e etikës së komunikimit dhe sjelljes qytetare;
 - c. të respektojnë personelin akademik, ndihmës-akademik dhe personelin administrativ, shokët dhe rregullat e mësimit; t'u drejtohen personelit akademik dhe atij administrativ në vetën e dytë shumës, si edhe me titujt akademikë përkatës;
 - d. të mos kryejnë veprime dhe gjeste provokuese apo ngacmuese ndaj personelit akademik apo studentëve të tjerë në mjediset e institucionit;
 - e. të mos ofrojnë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime, vetë apo nëpërmjet personave të tjerë, me qëllim marrjen e rezultateve të larta apo favorizime të tjera, të cilat lektori apo anëtarë të tjerë të personelit të Universitetit mund t'i kryejnë për shkak të detyrës;
 - f. të mos kopjojnë, të mos kryejnë akte që dëmtojnë procesin mësimor si dhe të mos shmangen nga shlyerja e detyrimeve akademike;
 - g. të mos konsumojnë pije alkoolike apo duhan në mjediset e brendshme të institucionit;

- h. të mos përdorin celular dhe ta mbajnë atë të fikur gjatë orarit të mësimit ose provimit në auditor, me përjashtim të rasteve kur nevojitet për qëllime didaktike;
 - i. Studenti, i cili përfshihet në një veprim të ndaluar apo thyrje ligji, i cili rezulton në prishjen e orës së mësimit, mund të drejtohet nga pedagogu të lërë auditorin për periudhën e mbetur të orës së mësimit. Për përjashtime më të gjata si pasojë e prishjes së orës së mësimit, duhet të merren vendime me shkrim nga organet përkatëse.
2. Studentët e akuzuar për shkeljen e këtij Kodi kanë të drejtat e mëposhtme:
- a. të kenë në dispozicion të gjitha politikat dhe procedurat e Universitetit lidhur me funksionimin e procesit disiplinor;
 - b. të vihen në dijeni dhe të sqarohen, siç kërkohet, për akuzat e mbetura pezull;
 - c. të jenë të lirë nga kërcënimet e personelit të Universitetit në zgjidhjen e çështjes disiplinore;
 - d. të përballen me akuzuesin/it dhe të kenë mundësi të ripyesin ata/ndonjë dëshmitar të pranishëm;
 - e. të jenë të lirë nga kontrollet apo konfiskimet, përjashtuar rasteve kur këto bazohen në shkaqe të arsyeshme dhe nga zyrtarët përkatës.

Neni 17 Sjelljet e ndaluara

Sjelljet e ndaluara në Universitetin "Fan S. Noli" Korçë përfshijnë, por nuk janë të kufizuara vetëm në:

1. Ndërhyrja ose pengimi në plotësimin e detyrave të personelit të Universitetit.
2. Bllokimi i hyrjes apo daljes të çdo godine të Universitetit.
3. Dëmtimi i pronës apo aseteve të Universitetit.
4. Përdorimi apo shpërndarja e lëndëve narkotike, apo të pakontrolluara.
5. Çdo përpjekje apo kërcënim i qëllimshëm për të dëmtuar një person tjetër.
6. Krijimi i aktiviteteve, forumeve apo klubeve që përbëjnë shkelje ndaj politikave të Universitetit dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë.
7. Falsifikimi apo manipulimi i dokumenteve zyrtare të Universitetit.
8. Përdorimi i çdo mjete elektronik të Universitetit për qëllime të jashtëligjshme apo të papërshtatshme.
9. Vjedhja ose përpjekja për të vjedhur pronën dhe/ose shërbimet e Universitetit.

10. Dhënia e deklaratave të pavërteta (me shkrim ose me gojë) për personelin e universitetit, studentët ose anëtarëve të familjeve të tyre, që padrejtësisht çënojnë reputacionin e tyre.

Neni 18

Sjellja e papërshtatshme akademike

Sjellja e papërshtatshme akademike përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

1. Plagjiatura – përdorimi i fjalëve, ideve, koncepteve apo të dhënave të një personi tjetër, pa e cituar burimin e tij. Ajo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:
 - a) Kopjimi pa treguar, paragrafët ose pjesë të punës elektronike, dhe/ose kopjimi i punës të tjerëve në detyra, si detyra shtëpie, ese, artikuj, tema diplome (disertacione);
 - b) Përdorimi pa treguar pikëpamjet, opinionet apo njohuritë e të tjerëve.
2. Kopjimi i përgjigjeve nga një student tjetër në provim.
3. Lejimi i një studenti të kopjojë përgjigjet.
4. Realizimi i provimit nga një person tjetër, në vend të studentit që ka emrin në procesverbal.
5. Lejimi i materialeve të pautorizuara, përgjigjeve të parapërgatitura, shënimeve gjatë provimit.
6. Lejimi i pajisjeve elektronike që kanë përgjigjet e provimit.
7. Fotografimi i tezës të provimit.

PJESA III MASAT DISIPLINORE

Neni 19

Denoncimi/raportimi i shkeljeve ose paraqitja e ankesës/kërkesës

1. Çdo person që është subjekt i aplikimit të dispozitave të këtij Kodi ka të drejtë të denoncojë apo raportojë shkelje të dispozitave të tij.
2. Ankesa/kërkesa, lidhur me pretendimet për shkelje të këtij Kodi, duhet të ketë të përcaktuar individin që bën ankesën dhe individin ndaj të cilit bëhet ankesa. Si rregull, ankesa/kërkesa paraqitet me shkrim pranë Zyrës së Protokollit të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë dhe i drejtohet Këshillit të Etikës.

Neni 20

Llojet e masave disiplinore

1. Përveç shkeljeve që ndëshkohen nga dispozitat e Statutit dhe të Rregullores së Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, si dhe të atyre që përbëjnë figurë veprash penale dhe që trajtohen nga dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, shkelja e dispozitave të parashikuara në këtë Kod përbën shkelje disiplinore për të cilën parashikohen këto lloj masash disiplinore:
 - a. Tërheqje vëmendje;
 - b. Vërejtje me shkrim;
 - c. Vërejtje me paralajmërim për përjashtim nga Universiteti.
2. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Këshilli i Etikës bazohet në:
 - Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;
 - Shkallën e fajësisë;
 - Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme.
3. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. Caktimi i masave ndëshkuese do të ketë karakter progresiv, përveç rasteve kur shkeljet janë të rënda ose të përsëritura.
4. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë.
5. Në rast se këto shkelje bëhen të përsëritura, Këshilli i Etikës i propozon autoritetit drejtues të institucionit ndëshkime të tjera më të rrepta, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Masat disiplinore të dhëna sipas parashikimit të këtij Kodi shuhet, për shkak të ligjit, pas kalimit të këtyre afateve:

- 1 vit nga njoftimi i masës së parashikuar në gjermën a të pikës 1 të këtij neni;
- 2 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në gjermën b të pikës 1 të këtij neni;
- 1 vit nga njoftimi i masës së parashikuar në gjermën c të pikës 1 të këtij neni.

Neni 21

Organi disiplinor

1. Këshilli i Etikës është organi që krijohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe me Statutin e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë.
2. Këshilli i Etikës mbledhet si rregull një herë në muaj, përveç rasteve kur pranë tij janë paraqitur kërkesa apo ankesa nga subjektet e këtij Kodi.
3. Këshilli i Etikës thirret në mbledhje nga kryetari i tij.
4. Mbledhjet e Këshillit të Etikës kryesohen nga kryetari dhe procesverbali mbahet nga sekretari. Këto mbledhje janë të vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë të tij.
5. Këshilli i Etikës shqyrton vetëm rastet kur denoncimi, ankesa apo raportimi kanë të përcaktuar individin që bën ankesën, si dhe individin ndaj të cilit është bërë ankesa.
6. Këshilli i Etikës merr vendim brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës/ankesës.

Neni 22

Procedura për shqyrtimin dhe verifikimin e shkeljeve

1. Verifikimi dhe shqyrtimi i ankesave/kërkesave të paraqitura nga subjektet e këtij Kodi, bëhet nga Këshilli i Etikës.
2. Anëtarët e Këshillit të Etikës, personat që kanë paraqitur ankesën/kërkesën si dhe personat ndaj të cilëve është bërë ankesa, gjatë kryerjes së proceduarve të verifikimit dhe shqyrtimit, deklarojnë çdo lloj konflikti interesi që mund të kenë.
3. Këshilli i Etikës shqyrton kërkesën/ankesën në përputhje me procedurat e parashikuar në këtë Kod.
4. Pas marrjes së kërkesës/ankesës kryetari thërret mbledhjen e Këshillit të Etikës.
5. Këshilli i Etikës shqyrton çështjen në seancë të mbyllur, ku duhet të jenë të pranishëm jo më pak se 4 anëtarë të tij.

6. Për mbledhjet e Këshillit të Etikës mbahet procesverbal nga sekretari ose në mungesë të tij nga një anëtar i caktuar nga kryetari. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Etikës të pranishëm në mbledhje.
7. Këshilli i Etikës thërret në seancë dëgjimore personin/personat që kanë bërë ankesën, si dhe personin/personat ndaj të cilëve është bërë ankesa. Personat duhet të paraqiten personalisht në mbledhjen përkatëse të Këshillit të Etikës.
8. Personi/personat që ka bërë ankesën, si dhe personi/personat kundër të cilit është bërë ankesa, ka të drejtë të paraqesë dokumente dhe materiale të tjera për të vërtetuar pretendimet e tij.
9. Këshilli i Etikës mund të thërrasë në seancë dëgjimore edhe persona të tjerë, kur e çmon të nevojshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes.
10. Pas ezaurimit të të gjithë procedurës të parashikuar më sipër, Këshilli i Etikës, ka detyrimin që të këshillojë palët (ankuesin/kërkuesin apo personin ndaj të cilit drejtohet ankesa/kërkesa) dhe t'ju propozojë atyre që të zgjidhin konfliktin/çështjen me marrëveshje.
11. Në rast se nuk arrihet ndonjë marrëveshje mes palëve, Këshilli i Etikës, pasi ka shqyrtuar çështjen dhe dëgjon personat përkatës, vendos me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm (vendimi kërkon jo më pak se katër vota).
12. Vendimi i Këshillit të Etikës për konstatimin ose jo të shkeljes së dispozitave të këtij Kodi duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët dhe përmban:
 - Organin të cilin ka marrë vendimin;
 - Personin që ka bërë ankesën;
 - Personin të cilit i atribuohet ose jo shkelja dhe strukturën ku ai bën pjesë;
 - Shkeljen faktike, nëse ka;
 - Bazën ligjore;
 - Arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve që janë bërë shkas për marrjen e vendimit;
 - Llojin e masës së propozuar;
 - Datën e hyrjes në fuqi të vendimit, që është data e njoftimit të vendimit.
13. a. Vendimi i Këshillit të Etikës i përcillet për miratim Rektorit/Administratorit, sipas rastit;
- b. Në rast se Rektor/Administratori kanë konflikt interesi me personat apo çështjen, atëherë Këshilli i Etikës ia përcjell për miratim masën disiplinore Senatit Akademik/Bordit të Administrimit.

14. Brenda 3 ditëve nga miratimi i vendimit të Këshillit të Etikës, një kopje e tij i komunikohet personit që ka bërë ankesën, personit kundër të cilit është bërë ankesa, autoritetit drejtues të njësisë kryesore apo njësisë bazë ku zhvillon aktivitetin (akademik, ndihmës-akademik, administrativ apo studentor) personi, si dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore (përveç rasteve kur personi ndaj të cilit merret masa disiplinore është student).

Neni 23

Dispozita kalimtare

1. Ky Kod shfuqizon Kodin e mëparshëm të Etikës si dhe Rregulloren e Etikës.
2. Ky Kod e shtrin veprimtarinë duke filluar nga viti akademik 2022-2023.

MIRATUAR:
SENATI AKADEMIK
KRYETARI
Prof.dr. Dhimitri Bello

